



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 650 Akti

V E N D I M
CAKTIM MASE SIGURIMI

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere nga :

ANTONELA PRENDI - GJYQTARE

asistuar nga sekretare gjyqesore Dila Doçi, sot ne 21.04.2016 mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore, kerkesen penale me Nr. Akti 650 qe i perket :

K E R K U E S:

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, perfaqesuar nga prokurori Dritan Rreshka.

O B J E K T I:

Caktim i mases se sigurimit pasuror sekuestro preventive ne kuader te procedimit penal nr 5326, dt 23.06.2015. Vendorsjen e sekuestros preventive mbi llogarine me nr. 46323, ne emer te shtetasit R. Dh. prane "Venetto Bank" sh.a dhe shumes se depozituar ne kete llogari ne date 11.04.2016 ne vleren 30,000 (tridhjete mije) Euro.

BAZA LIGJORE:

Nenet 228, 229, 274 te K Pr Penale.

Ne konkluzionet perfundimtare:

Prokurori kerkoi pranimin e kerkeses. Vendorsjen e sekuestros preventive mbi

llogarine me nr. 46323, ne emer te shtetasit R. Dh.prane "Venetto Bank" sh.a dhe shumes se depozituar ne kete llogari ne date 11.04.2016 ne vleren 30,000 (tridhjete mije) Euro.

Gjykata pasi degjoi diskutimet perfundimtare, deklaroi te mbyllur shqyrtimin gjyqesor dhe si çmoi provat ne teresi

VEREN

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ka paraqitur per gjykim kerkesen penale me objekt "*Caktim i mases se sigurimit pasuror sekuestro preventive ne kuader te procedimit penal nr 5326, dt 23.06.2015. Vendosjen e sekuestros preventive mbi llogarine me nr. 46323, ne emer te shtetasit R. Dh. prane "Venetto Bank" sh.a dhe shumes se depozituar ne kete llogari ne date 11.04.2016 ne vleren 30.000 (tridhjete mije) Euro*".

Nga analiza e provave te lejuara per shqyrtim rezultoi se :

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ka rregjistruar procedimin penal nr. 5326, date 23.06.2015 per vepren penale te "*Pastrimit te produkteve te vepres penale ose aktiviteteve kriminale*", te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal

Nga permbajtja e akteve te ceshtjes rezulton se nga ana e Seksionit per Pastrimin e Parave prane Drejtorise se Policise se Qarkut Tirane jane grumbulluar te dhena qe krijojne dyshime ne lidhje me shtetasin R. A. Dh. dtl 24.09.19... Nga te dhenat e siguruara konstatohet se bashkeshortja e tij, shtetasja B. B., ka përfiturar në llogarinë e saj individuale nr 4.....1 pranë Bankës Kombëtare Tregtare shumë 56 900 Euro nëpërmjet 4 transfertave të urdhëruara nga kompania "T... SA" në Zvicër me përshkrimin "finanziamento". Tre transfertat e para të mbërritura në kete llogari ne shumen prej 36,927 Euro jane terhequr pjesë - pjesë në cash, me qëllim investimin e tyre në biznes. Nga informacione të tjera rezulton se shtetasja B. B. është ortake me 100% të aksioneve dhe përfaqësuese ligjore në subjektin "B. B. - PF" me NIPT L5....S të regjistruar në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr...., Rruga e Në këtë aktivitet tregëtar ajo bashkëpunon edhe me shtetasin R. A. Dh., për të cilin ka deklaruar se është bashkëshorti i saj, madje është ai i cili ka realizuar edhe "marrëveshjen

e borxhit" me subjektin zviceran "T... SA". Gjithashtu edhe shtetasi R. Dh. ka çelur llogari pranë Bankës Kombëtare Tregtare. Ne muajin dhjetor 2014 ka çelur llogari rrjedhëse në Euro, CHF dhe në Leke (numri i llogarisë është 4...0) si person juridik, R. Dh. - PF me NIPT L4...7A, ndërsa në muajin Mars të vitit 2014 ka çelur llogari rrjedhëse individuale në Euro, CHF dhe në Lek (numri i llogarisë është 4...5);

Nga verifikimet dhe te dhenat e grumbulluara në lidhje me shtetasin R. Dh. si dhe familjarëve të tij përkatësisht E. A. Dh. e datëlindjes 03.07.19..., e cila rezulton e martuar me shtetasin me gjeneralitetet V. A. dhe shtetasja F. A. Dh., datëlindja 23.08.19..., e cila rezulton e martuar me shtetasin L. Z. rezulton se ka transaksione të vlerave monetare vetëm në emër të shtetasit R. Dh.. Konkretisht në datë 03.04.2014 është kredituar llogaria e shtetasit R. Dh. pranë bankës Kombëtare Tregtare në vlerë 10,000 Euro me përshkrim "E. L. derdhje në llogari" burimi i të ardhurave është deklaruar "të ardhura personale të C. R. tërhequr nga Intesa San PaoloBank".

Sipas informacionit shkresor me Nr. ... Prot., date 09.09.2015 të ardhur nga Zyra Qendrore Interpol Tirana, ndër të tjera behet me dije se shtetasi R. A. Dh. është arrestuar në datë 29.03.2009 dhe denuar për veprën penale të "Trafikimit të lendeve narkotike" (5.148 kg) heroine me 5 vjet e 4 muaj burgim në Itali.

Shtetasi R. Dh. me datë 11.04.2016 ka derdhur cash pranë "Veneto Bank" Sh.a (llogaria me nr. 4...) shumën prej 30.000 Euro, për të cilat ka deklaruar se i ka marrë hua nga shtetasi I. S. I, i lindur në Milano me datë 09.06.19.. e banues në Zvicër. Kjo shumë sipas deklarimeve të tij është sjelle fizikisht /cash në territorin e Republikës së Shqipërisë nga huadhënësi sipas itinerarit Zvicër - Itali - Shqipëri, pasqyruar kjo edhe në formularin e deklaramit në pikën e kalimit kufitar, sipas të cilit shtetasi I. I. ka deklaruar në Itali (dalje) shumën 30.000 Euro, shumë të cilën do e transportonte në Shqipëri me qëllim investimi dhe si burim të ardhurash është deklaruar nga puna. Po kështu nga verifikimet e vazhdueshme për shtetasit R. Dh. dhe B. B. për periudhën vijuese rezulton se ka transaksione të vlerave vetëm në emër të shtetasës B. B., e cila me datë 17.12.2015 ka blerë nga shtetasi G. C. pasuri të paluajtshme në vlerat 80.000 dhe 60.000 Euro.

Sa me sipër sipas organit të akuzës krijohen dyshime se shuma 30 000 Euro e depozituar pranë "Veneto Bank" sh.a në nr llogarise 4... në emër të

shtetasit R. Dh. është krijuar mbi bazën e të ardhurave të krijuara nga aktiviteti kriminal i tregetimit të lendeve narkotike. Për këtë arsye kërkohet vendosja e sekuestros preventive mbi këtë llogari bankare konform nenit 274/2 të KPrP me qëllim pengimin e disponimit të lirë të saj, fakt që mund të zjaste ose rëndonte pasojat e veprës penale "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose aktiviteteve kriminale" që aktualisht është duke u hetuar nga organi i akuzës në kuadër të procedimit penal 5326, dt 23.06.2015.

Gjykata pasi mori në shqyrtim kërkesën në raport me dispozitat procedurale penale dhe provat e lejuara për shqyrtim vendos pranimi e saj si të bazuar në ligj.

Neni 274 dhe 276 të KPrP sanksionojnë:

"Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose zjastë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale me kërkesën e prokurorit gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tyre me vendim të arsyetuar.

2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të Kodit Penal.

3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit gjykata me kërkesë të prokurorit ose të interesuarit e heq sekuestron (neni 274)

"1. Kunder vendimit për venien ose mosvenien e sekuestros çildo që ka interes mund të bëjë ankim.

2. Kërkesa e ankimit mund të paraqitet brenda 10 ditëve nga dhenia e vendimit ose nga dita kur i interesuari ka marrë dënimin për sekuestron e venë...."

Sekuestro preventive është masë sigurimi pasurore që aplikohet në rastet kur ka arsye të dyshohet se disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale rëndon ose zjastë pasojat e saj ose mund të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale. Vendosja e sekuestros në këtë rast pengon përdorimin dhe qarkullimin e lirë të sendeve që lidhen me veprën penale duke garantuar në këtë mënyrë nevojat e sigurimit. Sekuestrimi vendoset mbi çdo lloj pasurie që lejohet të konfiskohet në bazë të nenit 36 të Kodit Penal ku përfshihen dhe produktet e veprës penale (Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie....)

Nga provat e nenshtruara shqyrtimit gjyqesor rezulton se organi i akuzes ka nisur procedimin penale per vepren penale te “ *Pastrimit te produkteve te vepres penale*” dhe ekzistojne prova te mjaftueshme per te krijuar dyshimin e arsyeshem se kjo veper mund te jete konsumuar nga personi nen hetim R. Dh..

Nga te dhenat e siguruara nga organi i akuzes rezulton se shtetasi R. Dh.R. Dh. ka qene i denuar ne Itali per perfshirje ne aktivitete kriminale te lidhura me trafikun e lendeve narkotike. Nisur nga ky aktivitet kriminal, vlerat monetare te depozituara prej tij ne banka te nivelit te dyte, transaksionet e kryera, te cilat nuk justifikohen nga pikepamja ekonomike pasi nuk identifikohen burimet e ligjshme te te ardhurave dhe per me teper depozitimet dhe transaksionet e shpeshta te kryera dhe nga persona ne rreth te ngushte familjare krijojne dyshimin e arsyeshem te bazuar ne prova se burimi i krijimit te pasurise jane te ardhura te siguruara nga aktiviteti kriminal.

Ne rastin objekt gjykimi ka dyshime te bazuara ne prova se pasuria e luajtshme ne emer te shtetasit R. Dh. dhe konkretisht shuma prej 30.000 Euro e depozituar ne llogarine e ketij shtetasi me nr. 4... prane "Venetto Bank" sh.a eshte krijuar mbi bazën e të ardhurave të siguruara nga veprat penale ne fushen e tregtimit dhe trafikimit te lëndëve narkotike. Nisur nga aktivitetit kriminal i te dyshuarit, denimi i tij ne Itali, depozitimi i shumes ne cash ne llogari nga nje person jo rezident I. S. I. (shume e deklaruar si e sjelle nga Zvicra), mungesen e ndonje lidhje te mundshme ndermjet ketij te fundit dhe shtetasit R. Dh., faktit qe shtetasit B. B. dhe R. Dh. vazhdimisht perfitojne fonde qe kane si origjine Zvicren, faktit qe keto te ardhura nuk justifikohen nga pikepamja ekonomike sepse nuk identifikohen burimet e ligjshme si edhe faktit qe sigurimi ose krijimi i ketyre te ardhurave eshte pas periudhes se dyshuar kriminale, krijohet dyshimi i arsyeshem dhe i bazuar ne prova se burimi i kesaj pasurie (llogari bankare) jane te ardhurat e siguruara nga aktiviteti kriminal i shtetasit R. Dh..

Ne keto kushte gjykata vlereson se eshte e nevojshme te zbatohet masa e sigurimit “ sekuestro preventive “ mbi llogarine bankare me nr. 4... te personit nen hetim R. Dh. prane "Venetto Bank" sh.a dhe mbi shumen 30,000 (tridhjete mije) Euro te depozituar ne kete llogari me dt 11.04.2016 ne baze te nenit 274 te KPrP. Kjo mase cmohet e nevojshme per te shmanguar qarkullimin e metejshem civil te produktit te vepres penale, i cili rrezikon te transformohet ose shnderrohet ne pasuri te tjera, duke renduar e zjatur me tej pasojat e vepres penale.

PER KETO ARSYE

Mbeshtetur ne nenin 274 te K Pr Penale, gjykata

V E N D O S I

1. Pranimin e kerkeses.
2. Vendosjen e sekuestros preventive mbi llogarine me nr. 4... ne emer te shtetasit R. Dh. prane "Venetto Bank" sh.a dhe shumes se depozituar ne kete llogari ne date 11.04.2016 ne vleren 30,000 Euro.
3. Ngarkohen oficeret e policise gjyqesore per ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi.
4. Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 10 diteve nga shpallja e vendimit. Per subjektet e interesuara ky afat fillon nga dita e venies ne dijeni te sekuestros.

U shpall ne Tirane date 21.04.2016

S E K R E T A R E

G J Y Q T A R E

DILA DOÇI

ANTONELA PRENDI